

<i>RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR</i>	DK-01
<i>ver. 1.0</i>	<i>Jaqe 1 nga 14</i>

INSTITUTI I KOSOVES PËR DREJTËSI – IKD

**RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR SIPAS
PROCEDURAVE TË RËNA DAKORD**

Për

***PASQYRAT FINANCIARE TË PREZANTUARA PËR VITIN
2015***

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	DK-01
<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 14</i>

PËRMBAJTJA

	<u>Faqet</u>
Hyrje.....	3
Përgjegjësia e menaxhmentit për raportimet financiare.....	3
Përgjegjësit e auditorit.....	3
Opinionit i auditorit.....	5
Shënimet e përgjithshme për subjektin auditues.....	6
Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve gjithëpërfshirëse.....	7
Pasqyra e Rrjedhjes së Parasë.....	8
Shpalosjet dhe politkat kontabel.....	10
Shënimet shpjeguesë.....	12

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	DK-01
<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 3 nga 14</i>

I. HYRJE

Kemi qenë të angazhuar për auditimin e Pasqyrave Financiare të OJQ "Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)" për vitin 2015 që përfshijnë:

- Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve Gjithëpërfshirëse
- Pasqyrën e Rrjedhjes së Parasë;
- Shpalosjet dhe shënimet shpjeguese.

II. PËRGJEGËSIA E MENAXHMENTIT PËR PASQYRAT FINANCIARE

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontroleve të brendshme që është e rëndësishme për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare të cilat janë të liruara nga gabimet materiale, qoftë nga mashtrimet apo gabimet gjatë përzgjedhjes apo aplikimit të politikave të përshtatshme kontabël, si dhe realizimin e vlerësimeve kontabël që janë të arsyeshme në rrethana të caktuara.

III. PËRGJEGJËSIT E AUDITORIT

Përgjegjësia jonë është të shprehim mendim për Pasqyrat Financiare, të cilat i kemi aplikuar gjatë procedurave audituese.

Auditimin e kemi zhvilluar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit dhe Auditimit. Këto standarde kërkojnë që të jemi në përputhshmëri me kërkesat etike. Planifikimi dhe kryerja e auditimit kërkon që të arrijmë siguri të arsyeshme nëse Pasqyrat Financiare ekzistojnë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave dhe ekzaminimeve për të siguruar dëshmi të mjaftueshme për shpalosjet e vlerave të prezantuara në transaksionet e Pasqyrave Financiare.

Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e rrezikut për gabimet materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i gabimit apo mashtrimit të ndodhur.

Ne kryerjen e vlerësimeve të rrezikut auditori e merrë për bazë kontrollet e brendshme relevante për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare në mënyrë që dizajnimi i procedurave të auditimit të jenë të përshtatshme për rrethana të caktuara, por nuk ka qëllim të shprehjes së medimit për qëllime të kontroleve të brendshme të entitetit.

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	DK-01
<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 14</i>

Auditimi përfshin vlerësimin e duhur të politikave të përdorura kontabël si dhe arsyeshmërin e vlerësimeve të bëra nga Menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të Pasqyrave Financiare.

Ne besojmë që dëshmit e ofruara nga Menaxhmenti për auditim janë të mjaftueshme dhe të duhura që të ofrojnë bazë për opinion tonë.

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	DK-01
<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 14</i>

IV. OPINIONI I AUDITORIT

Sipas Raportimeve Financiare dhe rezultatet për aktivitetet e prezantuara për flukset hyrëse dhe dalëse financiare të prezantuara nga OJQ "Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) për vitin 2015, konstatojme se Pasqyrat Financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe reale sipas Standartëve Ndërkombetare për Raportim Financiar dhe Standarteve Kombetare të Kontabilitetit për vitin 2015. Bazuar në këto vlerësime paraqesim opinion pa rezervë për transaksionet e prezantuara në Pasqyrat Financiare nga kompania e audituar.

Kryerësi i shërbimeve audituese:

Shaqir Rexhepi;

Auditor Ligjor



Datë: 15 prill 2016

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	DK-01
<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 6 nga 14</i>

V. SHËNIMET E PËRGJITHSHMË PËR OJQ-IKD

Rreth Organizatës:

Instituti i Kosovës për Drejtësi (më tutje IKD) është organizatë e politikave publike jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse, e specializuar në sektorin e drejtësisë, e themeluar në shkurt të vitit 2009

Misioni i Organizatës

Misioni i IKD-së është forcimi i sundimit të ligjit në Kosovë dhe përmirësimi i qasjes në drejtësi për qytetarët. IKD udhëhiqet nga Kuvendi i Anëtarëve, Drejtori Ekzekutiv si dhe Bordi Këshillëdhënës. IKD synon që të përmbush misionin e saj përmes zhvillimit të hulumtimeve dhe analizave të pavarura dhe komunikimit të këtyre hulumtimeve tek politik bërësit, zyrtarët shtetëror, diplomatët ndërkombëtar, aktivistët e shoqërisë civile, dhe komuniteti akademik.

Adresa e zyrës:

Rruga "Hajdar Dushi". Objekti C2, Hyrja 2 nr. 8

10000 Prishtinë,

Republika e Kosovës

Mob: +377 44 279 144

E-mail: info@kli-ks.org

Ueb: www.kli-ks.org

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	DK-01
ver. 1.0	faqe 7 nga 14

VI. Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve Gjithëpërfshirëse

Pasqyra e performancës financiare për vitin që përfundon më 31.12.2015

I. Të Hyrat Financiare		Shënime	Shuma
1	Ambasada e Britanisë së Madhe (Projekti antikorrupsion I)	1.1	62,674.92
2	Ambasada e Britanisë së Madhe (Projekti antikorrupsion II)	1.2	26,958.46
3	Radio-Televizioni i Kosovës, RTK	1.3	20,000.00
4	Hulumtimi Parlamentar (KDI)	1.4	1,820.00
5	Të hyrat e shtyra nga Radio-Televizioni i Kosovës, RTK 2014	1.5	8,498.17
6	Të hyrat e shtyra tjera (nga mbetjet 2014)	1.6	90.81
I. Gjithsej të hyrat Financiare			120,042.36
II Shpenzimet operative dhe afariste			
1	Pagat dhe mëditjet e punëtorëve	2.1	72,190.50
2	Shpenzimet e Produksionit	2.2	21,769.30
3	Shpenzimet tjera operative	2.3	17,880.61
II Gjithsej shpenzimet operative			111,840.41
III. Teprica e të hyrave më 31.12.2015		3	8,201.41

TË AUTORIZUARA NGA:
BETIM MUŠLIU

Drejtor Ekzekutiv



TË PËRPILUARA NGA:
XHELADIN BYTYQI,

Udhëheqës financiar

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	DK-01
<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 8 nga 14</i>

VII. Pasqyra e Rrjedhjes së Parasë

Pasqyra e rrjedhës së Parasë të gatshme për vitin që përfundon më 31.12.2015

I. Pranimi i parasë nga aktivitetet operative	Shën	Shuma
1 Paraja e pranuar nga aktivitetet operative (faturimet)	2	20,000.00
I. Gjithsej paraja e pranuar nga aktivitetet operative		20,000.00
II Pagesat për aktivitete operative		
1 Pagat dhe mëditjet e punëtorëve		-72,190.50
2 Pagesat e shpenzimeve të Produksionit		-21,769.30
3 Pagesat për organizimin e Tryezave dhe Konferencave		-3,714.06
4 Pagesat për WEB faqen		-600.00
5 Pagesat për qira		-4,509.50
6 Pagesat për udhëtim dhe transport		-4,324.02
7 Pagesat e shpenzimeve të komunikimit		-1,315.50
8 Pagesa e shpenzimeve të zyrës dhe shpenzimeve tjera		-2,493.75
9 Pagesa e auditimit		-500.00
10 Pagesat për shërbimet komunale (rrymë, ujë, mbeturina)		-423.78
II Gjithsej pagesat për aktivitete operative		-111,840.41
III Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operuese		-91,840.41
IV Pranimi i parasë nga aktivitetet investuese		Shuma
1 Paraja e pranuar nga shitja e pajisjeve		0.00
IV Gjithsej paraja e pranuar nga aktivitetet investuese		0.00
V Pagesat për aktivitetet investuese		
1 Paraja e paguar për blerjen e pajisjeve		0.00
VI Paraja nga aktivitetet investuese		0.00
VII. Pranimi i parasë nga aktivitetet financuese		Shuma
1 Donacionet e pranuar në para të gatshme		91,453.38
VIII. Gjithsej paraja e pranuar nga aktivitetet financuese		91,453.38

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	DK-01
<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 9 nga 14</i>

	Daljet e parasë nga aktivitetet financuese	0.00
IX	Gjithsej pagesat për aktivitetet financuese	0.00
X	Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese	91,453.38
XI	Paraja e gjeneruar në fund të vitit nga të tre aktivitetet	-387.03
XII	Paraja në fillim të periudhës	8,588.98
XIII	Paraja në fund të periudhës	8,201.95

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	DK-01
<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 10 nga 14</i>

VIII. SHPALOSJET DHE POLITIKAT E KONTABILITETIT HISTORIKU DHE INFORMACIONET OPERATIVE TË IKD

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) aktivitetin e saj e zhvillon që nga muaji qershor i vitit 2009 dhe është regjistruar si Organizatë joqeveritare në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike.

Selia e organizatës është në Prishtinë.

Themeluesit e organizatës janë: Kujtim Kërveshi, Adelina Sokoli – Pallaska, Behlul Zeka
Veprimtaria kryesore e IKD është: rritja e nivelit të transparencës, respektimi i të drejtave të njeriut, pjesëmarrja e grupeve të interesit në proceset legjislative si praktikë e njohur ndërkombëtare dhe evropianë.

IKD ka Statutin e themelimit, dhe udhëzimet e brendshme në bazë të të cilave i kryen aktivitetet e përditshme dhe kontrollat e brendshme.

IKD zhvillon hulumtime, organizon ngjarje (tryeza/konferenca) dhe përfshihet në vazhdimësi në avokim në këto fusha:

- Reformën gjyqësore
- Sundim të ligjit
- Iniciativat legjislative
- Zbatimin e ligjeve
- Përputhshmërinë e legjislacionit vendor me standardet e BE-së dhe OKB-së
- Edukimin ligjor
- Edukim Medial

Personeli i IKD-së ka përvojë në kapacitete të ndryshme në sektorin e drejtësisë në Kosovë, duke përfshirë zhvillimin e hulumtimeve, raportimet gazetare, ngritjen e vetëdijes dhe përfshirjen në aktivitete të avokimit. Këtu përfshihet puna e ngushtë me autoritetet e

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	DK-01
<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 14</i>

Kosovës për të siguruar pavarësi, paanshmëri dhe ngritje të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E PËRGJITSHME TË KONTABILITETIT

POLITIKAT E KONTABILITETIT

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të aprovuara nga Bordi për Standarde në Raportimet Financiare. Raportet janë përgatitur në bazë të kostos historike.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas kontabilitetit aktual të orientuar prej SKK-ve të modifikuara me kontabilitetin mbi bazën e Parasë së Gatshme për njohjen e pasurive afatgjata materiale , amortizimeve të lidhura me aktivitetin jo fitimprurës të IKD, të cilat janë njohur si shpenzime në momentin kur ato janë blerë lidhur me projekte të caktuara.

Pasqyrat janë përgatitur duke respektuar tërësinë materiale, në harmoni me kushtet dhe kriteret e menaxhimit të garantëve të dhuruara nga ana e donatorëve, si dhe në kuptim me udhëzimet dhe këshillimet e termave kontraktuese me secilin donator veç e veç.

Organizata harton përmbledhjen e shpenzimeve sipas linjave të buxhetit të projektit të miratuar për secilin projekt duke përgatitur një pasqyrë të shpenzimeve të kryera (Raport Financiar) në zbatim të periudhave të raportimit të nënshkruar në kontratën e garantëve.

Në përgjithësi këto rregulla dhe procedura duke pasur parasysh specifikimin e paragrafit të parë të politikave kontabël janë të orientuara nga Standardet Kombëtarë dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	DK-01
<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 12 nga 14</i>

IX. SHËNIMET SHPJEGUESE

VALUTA E RAPORTIMIT

Librat dhe regjistrimet janë mbajtur në valutën Euro ("EUR"). Në përputhje me legjislacionin e Unionit Monetar Evropian dhe Udhëzimeve të lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ("BQK"), Euro është adoptuar si valutë legale në Kosovë prej 1 janarit 2002.

PARIMI I VAZHDIMËSISË

Organizata në aktivitetin e saj të vitit 2015 ka arritur një performancë pozitive dhe ka arritur të marr edhe fonde tjera për vitin vijues. Sipas mendimit tonë, Organizata është në gjendje të vazhdoj veprimtarinë e saj edhe me tutje.

ZHVLERËSIMI DHE/OSE AMORTIZIMI

IKD aktualisht nuk posedon pasuri me jetëgjatësi më shumë se një vit, prandaj nuk ka raportime për këtë pozicion.

PARAJA E GATSHME DHE EKUVALENTET E SAJ

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga paratë në arkë dhe paratë në bankë. Gjendja e parasë së gatshme më 31 dhjetor 2014 ishte 8,588.98€€, ndërsa më 31 dhjetor 2015 ajo ishte 8,201.95€.

TË HYRAT

Të hyrat e IKD janë nga kryerja e shërbimeve dhe nga donacionet e kontributet. Ato janë njohur në bazë të parimit aktual për njohjen e të hyrave. Të hyrat njihen me rastin e faturimit. Të hyrat e IKD për vitin 2015 kapin vlerën prej 120,042.36€.

Shënimi 1. Të hyrat nga RTK

IKD realizon të hyra nga RTK për bashkëprodhim të emisionit "Betimi për Drejtësi", që emitohet çdo javë në RTK. Gjatë vitit IKD i ka faturuar RTK-së në vlerë prej 43,200 €, ndërsa ka arkëtuar 20,000 €. RTK i ka borxh IKD-së 3,000€ nga viti 2014 dhe 23,200€ nga faturimet 2015 që gjithsejtë janë 26,200€, të cilat nuk janë njohur si të hyra të vitit 2014, por ato do të njihen kur të pranohen, pasi organizata raporton në bazë të parimit të parasë së gatshme.

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	DK-01
<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 13 nga 14</i>

SHPENZIMET

Shpenzimet janë njohur në bazë të parimit të parasë se gatshme për njohjen e shpenzimeve, të cilat njihen me rastin e faturimit.

Shpenzimet e IKD në vitin 2015 janë gjithsej 111,840.41€, ndërsa në vitin 2014 ishin gjithsej 123,956.98€, pra janë shpenzuar 12,156.16 € më pak.

Shpenzimet kryesore të IKD-së janë:

- a) paga: 72.190.50€.
- b) shpenzime të produksionit 21,769.30 € dhe
- c) shpenzimet tjera operative janë 17.880.61 €, të cilat janë shpalosur në Tabelën 1.

Shënimi 2. Shpenzimet tjera operative

Tab. 1 shpenzimet tjera operative

Nr	Përshkrimi	Viti 2015
		vlera
1	Shpenzimet për qira	4,509.50
2	Shpenzimet e udhëtimit dhe transportit	4,324.02
3	Shpenzimet për tryeza dhe konferenca	3,714.06
4	Shpenzimet e zyrës dhe tjera	2,493.75
5	Shpenzime e Komunikimit (telefon, internet)	1,315.50
7	Shpenzime e zyrës Shpenzimet për WEB faqen	600.00
8	Shpenzimet e auditimit	500.00
9	Shpenzime për shërbimet komunalie (rryma, uji, mbeturinat)	423.78
Gjithsej		17,880.61

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

DK-01

ver. 1.0

fajqe 14 nga 14

Tab. 2 Shpenzimet sipas projekteve

Nr	Përshkrimi	Ambasada e Britanisë 1	Ambasada e Britanisë 2	KDI	RTK	Tjera	Gjithsej
1	Paga dhe mëditje	16,412.30	48,428.20	1,000.0	6,350.00		72,190.50
2	Produksioni	5,769.30	6,000.00		10,000.0		21,769.30
3	Web faqe	300.00	300.00				600.00
4	Tryeza dhe konferenca	2,151.82	1,562.24				3,714.06
5	Qiraja	990.00	2,695.00		824.50		4,509.50
6	Auditimi				500.00		500.00
7	Transporti	554.70	2,453.79		1,315.53		4,324.02
8	Shpenzimet e komunikimit (telefon internet)	400.00	615.00		270.50	30.00	1,315.50
9	Shpenzime komunale (rrymë, ujë, mbeturina)	177.10	181.75		64.93		423.78
10	Shpenzime të zyrës dhe tjera	203.24	438.94	743.40	1,047.30	60.87	2,493.75
Gjithsej		26,958.46	62,674.92	1,743.40	20,372.76	90.87	111,840.41

Shënimi 3. Teprica e të hyrave

Teprica e të hyrave nga veprimtaria e aktiviteteve shpenzuese në raport me të ardhurat e arkëtuara gjate vitit 2015 janë 8,201.95 € dhe përbëhen nga:

- Teprica e mjeteve të arkëtuara nga Radio-Televizioni i Kosovës në vlerë prej 8,125.45 €, dhe
- Teprica e mjeteve të arkëtuara nga KDI për hulumtimin e kryer ne parlamentin e Republikës se Kosovës në vlerë prej 76.50 €.